



Duke u mbështetur ne nenin 17 nen pikën a, c, e dhe s) nenit 40 alineja 40.2 nen pikën I) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale 03/L-040, dispozitat e Ligjit për Planifikim Hapësinor nr.04/L-174, Planin Zhvillimor Komunal i miratuar sipas vendimit nr.06-5941/2015 të dt.26.11.2015, nenit 40 alineja 40.2 nen pikën 11 të Statutit të Komunës së Klinës si dhe Vendimit për miratim të Strategjisë së Zhvillimit Ekonomik të Komunës së Klinës 01nr.06-3613 të dt.05.07.2017, me kërkesën 04Nr.353-4611/18 të datës 28.06.2018, nga Drejtoria e Arsimit, Kuvendi i Komunës së Klinës në seancën e VI-të rregullt për vitin 2018, të mbajtur me datën 29.06.2018, mori këtë:

V E N D I M

Caktimi i lokacionit për ndërtimin e Qerdhes së Fëmijëve në Zonën Kadastra le Deiq, Komuna e Klinës

- I. Miratohet Vendimi për caktimin e lokacionit për ndërtimin e Qerdhes së Fëmijëve në Zonën Kadastrale në Deiq.
- II. Lokacioni si në pikën 1 të këtij vendimi caktohet në ngastrën nr.55/1 në sipërfaqe prej 0.30,00 ha. pronë shoqërore e Kuvendit të Komunës së Klinës, vendi GURINA.
- III. Lokacioni caktohet duke u mbështetur në kërkesën e Drejtorisë së Arsimit, më certifikatë të pronësisë numër 11-3972/2018 të datës 28.06.2018 si dhe kopjes se Planit nr.11/3372 të datës 28.06.2018.
- IV. Kompetent për ekzekutimin e këtij vendimi është Drejtoria e Arsimit në koordinim me Drejtorinë e Urbanizmit dhe MM dhe Drejtorin e Kadastrës, Gjeodezisë dhe Pronësisë.
- V. Ky akt hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal si dhe 7 ditë pas publikimit në ueb faqen zyrtare të Komunës së Klinës.
- VI. Me këtë vendim njoftohet: MAPL, Kryetari i Komunës, Drejtoria e Arsimit, Drejtoria e Urbanizmit dhe Mbrojtjes së Mjedisit, Zyra e Informimit, Shërbimi për punë të Kuvendit dhe Arkivi i Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS KLINË

01Nr 06-4722 2018
Klinë, me 04.07 2018

